

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BASHKIMIT EVROPIAN, PËR AKTIVITETET OPERACIONALE TË KRYERA NGA AGJENCIA EVROPIANE E ROJËS KUFITARE DHE BREGDETARE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Nisma për këtë marrëveshje është ndërmarrë nga Bashkimi Evropian dhe synon rregullimin e të gjitha çështjeve të nevojshme për dislokimin e ekipeve të menaxhimit të kufirit nga trupat e përhershme të Agjencisë së Rojës Kufitare dhe Bregdetare Evropiane në Republikën e Shqipërisë (në vijim Agjencia), ku anëtarët e ekipit mund të ushtrojnë kompetenca ekzekutive.

Lidhja e kësaj marrëveshjeje është shprehje e vullnetit nga ana e të dyja palëve për përcaktimin e zgjidhjeve të qëndrueshme në trajtimin e migracionit të paligjshëm dhe krimit ndërkufitar, duke respektuar të drejtat e njeriut dhe parimet demokratike, si parimet themelore, për të cilat bazohet ky bashkëpunim i ndërsjellë.

Në këtë mënyrë, me zbatimin e kësaj marrëveshjeje do të arrihet menaxhimi dhe zgjidhja e problematikave lidhur me migracionin dhe kërcënimet e mundshme në të ardhmen, si dhe zgjidhja e krimeve të rënda ndërkufitare.

Sipas marrëveshjes, bashkëpunimi bazohet në parimet e partneritetit dhe respektit të ndërsjellë, ku për secilin aktivitet operativ do të dakordësohet plani operativ ndërmjet Agjencisë dhe Republikës së Shqipërisë.

Marrëveshja detyron të gjithë personat që marrin pjesë në veprimtarinë operacionale të ruajnë standardet më të larta të integritetit, sjelljes etike, profesionalizmit dhe respektimit të të drejtave themelore, si dhe të përmbushin detyrimet që u ngarkohen nga dispozitat e planit operativ.

Bashkëpunimi ndërmjet Agjencisë së Rojës Kufitare dhe Bregdetare Evropiane dhe Republikës së Shqipërisë në territorin e Republikës së Shqipërisë ka nisur me hyrjen në fuqi të ligjit nr.6/2019, “Për ratifikimin e marrëveshjes statutores, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, për veprimet e

ndërmarrja nga Agjencia e Rojës Bregdetare dhe Kufirit Evropian në Republikën e Shqipërisë”, marrëveshje e cila do të shfuqizohet nga marrëveshja në fjalë, sikurse është parashikuar edhe në pikën 5, të nenit 22, të kësaj të fundit.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektligji nuk është parashikuar në programin e përgjithshëm analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2023 për Ministrinë e Brendshme, por kryhet në kuadër të përmbushjes së prioriteteve të qeverisë shqiptare në luftën kundër migracionit të paligjshëm dhe krimit ndërkufitar.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Përparësitë që priten nga zbatimi i këtij projektligji janë në lidhje me fushën e migracionit të paligjshëm dhe krimit ndërkufitar, ku palët do të forcojnë bashkëpunimin në këtë aspekt.

Palët do të ndërmarrin masa të përbashkëta kundër kërcënimeve ndërkufitare.

Bashkëpunimi ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë së Rojës Kufitare dhe Bregdetare Evropiane në territorin e Republikës së Shqipërisë ka nisur me hyrjen në fuqi të ligjit nr.6/2019, “Për ratifikimin e marrëveshjes statutore, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian, për veprimet e ndërmarrja nga Agjencia e Rojës Bregdetare dhe Kufirit Evropian në Republikën e Shqipërisë”, marrëveshje e cila do të shfuqizohet nga marrëveshja në fjalë.

Marrëveshja që është nënshkruar nga palët, në ndryshim nga marrëveshja në fuqi, synon forcimin e bashkëpunimit ndërmjet agjencive ligjzbatuese të Republikës së Shqipërisë, veçanërisht të Policisë së Shtetit me agjencitë e Bashkimit Evropian për kryerjen e aktiviteteve operacionale në të gjithë kufirin shtetëror, me të gjitha vendet fqinje. Marrëveshja, njëkohësisht, synon detajimin e disa dispozitave të lidhura me imunitetin e anëtarëve të ekipit, pajisjeve dhe ambienteve të përdorura nga Agjencia, bashkëpunimin në kuadër të luftës ndaj mashtrimeve, ngritjes së strukturave koordinuese dhe mbështetëse, siç është “Zyra e antenave”.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektligj është hartuar mbi bazën dhe nën frymën e respektimit të marrëveshjeve ndërkombëtare dhe në pajtim me legjislacionin kombëtar të të dyja palëve, pa paragjykuar angazhimet e tyre të mëparshme, bazuar në marrëveshjet dypalëshe e shumëpalëshe me vendet e treta. Për sa më sipër, marrëveshja dhe projektligji ratifikues, si për nga qëllimi, ashtu edhe për nga përmbajtja, janë në përputhje me Kushtetutën, legjislacionin për marrëveshjet ndërkombëtare, si dhe me aktet e tjera të legjislacionit të brendshëm. Nevoja për ratifikim buron nga fakti se në marrëveshje, sikurse është përshkruar në kreun I, të këtij relacioni, parashikohen rregulla që kanë të bëjnë me dislokimin e ekipeve të menaxhimit të kufirit nga trupat e përhershme të Agjencisë së Rojës Kufitare dhe Bregdetare Evropiane në Republikën e Shqipërisë, ku anëtarët e ekipit mund të ushtrojnë kompetenca ekzekutive. Për këtë arsye, është i nevojshëm ratifikimi i marrëveshjes, në mbështetje të nenit 121 të Kushtetutës. Nga pikëpamja procedurale, propozimi paraqitet në përputhje me nenin 17, të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE).

Ky projektligj nuk synon përafrim me *acquis* të Bashkimit Evropian, por është në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian dhe rregulloren (EU) 2019/1896 të Rojës Evropiane Kufitare dhe Bregdetare.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Marrëveshja është e strukturuar në 22 nene, ku parashikohen:

Pjesa e parë është pjesa hyrëse në të cilën parashikohen shkurtimisht parimet për të cilat do të bazohet veprimtaria e palëve, qëllimi për rregullimin e të gjitha çështjeve të nevojshme, lidhur me trajtimin e migracionit të paligjshëm dhe krimin ndërkufitar.

Neni 1 përcakton se marrëveshja do të rregullojë të gjitha çështjet e nevojshme për dislokimin e ekipeve të menaxhimit të kufirit nga trupat e përhershme të Rojës Kufitare dhe Bregdetare Evropiane në Republikën e Shqipërisë, ku anëtarët e ekipit mund të ushtrojnë kompetenca ekzekutive.

Në nenin 2 janë listuar përkufizimet, si Agjencia, kontroll kufitar, EUROSUR, monitorues i të drejtave themelore, shteti anëtar i origjinës, incident, operacion i përbashkët, anëtar ekipi, ndërhyrje e shpejtë kufitare, staf ligjor etj.

Neni 3 parashikon procedurën e nisjes së aktiviteteve operative, e cila nis me vendim me shkrim të drejtorit ekzekutiv të Agjencisë, duke parashikuar edhe vlerësimin e rasteve që mund të çojnë në shkelje serioze dhe/ose të vazhdueshme të të drejtave themelore ose detyrimeve të mbrojtjes ndërkombëtare, për të cilat nuk niset veprimtaria operacionale. Sipas këtij neni, drejtori ekzekutiv ka kompetencën për të mos nisur një aktivitet operacional.

Neni 4 parashikon se për një plan operacional dakordësohet për çdo aktivitet operacional, ndërmjet Agjencisë dhe Republikës së Shqipërisë dhe se miratohet me shkrim nga drejtori ekzekutiv dhe përfaqësuesi i autoritetit kompetent të Republikës së Shqipërisë. Plani operacional do të përcaktojë në detaje aspektet organizative dhe procedurale të veprimtarisë operacionale.

Neni 5 parashikon se Agjencia dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit do të kenë një mekanizëm raportimi të incidentit për të lejuar raportimin në kohë të çdo incidenti të hasur gjatë një aktiviteti operacional të kryer, sipas kësaj marrëveshjeje, dhe se palët do të bashkëpunojnë në kryerjen e të gjitha hetimeve të nevojshme për çdo incident të raportuar, duke identifikuar dëshmitarët apo duke mbledhur provat.

Në nenin 6 parashikohet se Agjencia, në konsultim me autoritetet përkatëse të Republikës së Shqipërisë, mund të krijojë zyra antenash në territorin e Republikës së Shqipërisë për të lehtësuar e përmirësuar koordinimin e aktiviteteve operacionale dhe për të siguruar menaxhimin efektiv të burimeve njerëzore e teknike të Agjencisë. Në vijim të nenit, parashikohet mënyra e menaxhimit të zyrës së antenave dhe detyrat e përfaqësuesit të Agjencisë që do të menaxhojë zyrën e antenave.

Neni 7 parashikon se pa cenuar rolin e zyrave të antenës, drejtori ekzekutiv do të caktojë një ose më shumë ekspertë nga stafi ligjor që do të vendosen si oficerë koordinues për çdo aktivitet operacional, duke njoftuar Republikën e Shqipërisë për këtë emërim. Më tej parashikohen detyrat e zyrtarit koordinues.

Neni 8 parashikon të drejtat themelore, në bazë të cilave bazohet hartimi dhe zbatimi i kësaj marrëveshjeje dhe në nenin 9 parashikohen detyrat e monitoruesit të të drejtave themelore që caktohet për çdo aktivitet.

Neni 10 parashikon kompetencat e anëtarëve të ekipit në lidhje me planin operativ që do të bëhet në territorin e Republikës së Shqipërisë. Në nenin 11 janë

përcaktuar privilegjet dhe imunitetet e pronës, fondet, pasuria dhe operacionet e Agjencisë dhe në nenin 12 janë parashikuar privilegjet dhe imunitetet e anëtarëve të ekipit.

Në nenin 13 parashikohet e drejta e drejtorit ekzekutiv për të marrë masat e duhura për riatdhesimin e çdo anëtari të ekipit të dëmtuar ose të vdekur, si dhe të pronës së tyre personale.

Neni 14 parashikon se Agjencia do t'i lëshojë çdo anëtari të ekipit një dokument në shqip dhe anglisht, për qëllime identifikimi përballë autoriteteve kombëtare të Republikës së Shqipërisë dhe dëshmi të të drejtave të mbajtësit për të kryer detyrat dhe për të ushtruar kompetencat e përmendura në nenin 10, të kësaj marrëveshjeje dhe në planin operacional (“dokumenti i akreditimit”).

Në nenin 15 parashikohet se nenet 12, 13 e 14 do të zbatohen “*mutatis mutandis*” për të gjithë personelin e Agjencisë, të dislokuar në Republikën e Shqipërisë, sipas kësaj marrëveshjeje ose sipas një plani operacional në bazë të saj, që nuk janë anëtarë të ekipit, duke përfshirë monitoruesit e të drejtave themelore dhe stafin ligjor të dislokuar në zyrat e antenave.

Në nenin 16 parashikohet mbrojtja e të dhënave personale dhe në nenin 17 parashikohen procedurat që do të ndiqen lidhur me shkëmbimin e informacionit të klasifikuar dhe të ndjeshëm jo të klasifikuar.

Neni 18 parashikon rastet se kur merret vendimi për pezullimin, ndërprerjen dhe/ose tërheqjen e financimit për një aktivitet operativ.

Në nenin 19 parashikohet se Republika e Shqipërisë do të njoftojë menjëherë Agjencinë, Prokurorinë Publike Evropiane dhe/ose Zyrën Evropiane Kundër Mashtrimit, nëse merr dijeni për ekzistencën e pretendimeve të besueshme për mashtrim, korrupsion ose çdo veprimtari tjetër të paligjshme që mund të cenojnë interesat e Bashkimit Evropian.

Nenet 20, 21 e 22 parashikojnë dispozitat përfundimtare, konkretisht, autoritetet e zbatimit të marrëveshjes, zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe hyrjen në fuqi, amendamentin, kohëzgjatjen, pezullimin dhe përfundimin e marrëveshjes

I. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Për Republikën e Shqipërisë autoritetet kompetente do të jenë Ministria e Brendshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Departamenti për Kufirin dhe Migracionin.

II. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Iniciativa për këtë projekt marrëveshje me palën tonë është ndërmarrë nga Bashkimi Evropian, sikurse është përmendur edhe në kreun I, të këtij relacioni. Marrëveshja është miratuar, në parim, me vendimin nr.338 datë 30.6.2023, të Këshillit të Ministrave. Pas nënshkrimit të saj nga palët, Ministria e Brendshme ka vijuar me hartimin e projektligjit ratifikues dhe me ndjekjen e procedurave në funksion të këtij qëllimi (propozimit të ratifikimit), në përputhje me nenin 121 të Kushtetutës, dhe të nenit 17, të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

III. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Zbatimi i marrëveshjes nuk sjell efekte financiare shtesë për buxhetin e shtetit.

KËSHILLI I MINISTRAVE